



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 12, datë 14.01.2021

MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË MAGJISTRATIT DANIELA SULAJ (KONICA), KANDIDAT PËR T'U KOMANDUAR INSPEKTOR PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË.

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 159, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neneve 32, 35 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, Rregullores “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “ Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të magjistratit, kandidat për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Daniela Sulaj (Konica)”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Daniela Sulaj (Konica), sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e vijimit të procedurës së komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kandidatit prokuror Daniela Sulaj (Konica).
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Daniela Sulaj (Konica).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**



ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKAJ

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

